



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



## Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 20.04.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 18.04.2023, të parashtruar nga Operatori Ekonomik " **PE -VLA-KU**" SH.P.K. DEGA NË KOSOVË, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i objektit të banimit social-Faza e dytë ", **Nr. i prokurimit- 632-23-1544-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-012-521**, nxjerr:

### V E N D I M

1. **Refuzohet** si e pabazuar Kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik " **PE -VLA-KU**" SH.P.K. DEGA NË KOSOVË. e dt.18.04.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i objektit të banimit social-Faza e dytë ", **Nr. i prokurimit- 632-23-1544-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-012-521**, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të datës 12.04.2023, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
2. **Vërtetohet** NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë: 12.04.2023;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të anulohet aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe të publikohet në platformën elektronike të KRPP.

### A r s y e t i m

Me dt.18.04.2023, Operatori Ekonomik " **PE -VLA-KU**" SH.P.K. DEGA NË KOSOVË, ka parashtruar Kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin prokurimit: "Ndërtimi i objektit të banimit social-Faza e dytë ", **Nr. i prokurimit- 632-23-1544-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-012-521**.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 20.04.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj i parë është i pabazuar sepse konzorciumi në fjalë i ka ngarkuar në sistem Vërtetimet e Gjykatës dhe të ATK-së dhe i ka sjellë kopjet fizike, mirëpo ju keni kërkuar qasje në të gjitha ofertat, por nuk keni kërkuar kopjet fizike të Vërtetimeve të Gjykatës dhe të ATK-së së firmës fituese;

Pretendimi juaj i dytë lidhur me qarkullimin bankar gjithashtu nuk qëndron, sepse lideri i grupit "Euro Construcion", ka prezantuar Deklaratat Tatimore Vjetore të tatimit në të Ardhura, të cilat mbulojnë 60% e qarkullimit të kërkuar, kurse anëtari tjetër i konzorciumit "Ideor Construcion" ka prezantuar Deklaratat Tatimore Vjetore të tatimit në të Ardhura, të cilat mbulojnë 40% e qarkullimit .

Pretendimi juaj i tretë lidhur me Aneksin 6-lista e kontratave, është i pabazuar, sepse lideri i konzorciumit "Euro Construcion" dhe anëtari tjetër i konzorciumit "Ideor Construcion" kanë paraqitur listën e kontratave dhe këto mbulojnë kërkesat e AK në dosjen e tenderit.

Pretendimi juaj i katërt lidhur me numrin e punëtorëve është i pabazuar sepse lideri i konzorciumit "Euro Construcion" ka paraqitur listën e punëtorëve (11 punëtorë) dhe anëtari tjetër i konzorciumit "Ideor Construcion"(12 punëtorë) dhe këto mbulojnë kërkesat e AK në dosjen e tenderit. Gjithashtu kanë paraqitur menaxherin e kontratës Jasmir Morina.

Pretendimi juaj i pestë është i pabazuar sepse AK, nuk ka kërkuar në dosjen e tenderit listën e pagesave të ATK-së, për punëtorët e prezantuar. Sa i përket asaj se anëtari tjetër i konzorciumit "A & E", nuk ka paraqitur listën e punëtorëve, sqarojmë se nuk është e nevojshme që të gjithë anëtarët e konzorciumit të paraqesin listën sepse mjafton që numri i kërkuar të plotësohet.

**Sa ju përket pretendimeve tuaja lidhur me OE "MBB Construcion",AK i ka shqyrtuar si më poshtë:**

Pretendimi juaj i parë lidhur me planin dinamik është i pabazuar, sepse AK nuk ka kërkuar të prezantohet plan dinamik;

Pretendimi juaj i dytë lidhur me lidhur me Deklaratat Tatimore Vjetore të tatimit në të Ardhura gjithashtu nuk qëndron, sepse OE "MBB Construcion", ka prezantuar Deklaratat Tatimore Vjetore të tatimit në të Ardhura, të cilat mbulojnë tërë vlerën e qarkullimit të kërkuar;

Pretendimi juaj i tretë lidhur me lidhur me qarkullimin bankar gjithashtu nuk qëndron, sepse OE "MBB Construcion"; ka prezantuar qarkullim bankar, të cilat mbulojnë tërë vlerën e qarkullimit të kërkuar;

Pretendimi juaj i katërt lidhur me dëshmitë se ka 15 punëtorë, është i pabazuar sepse OE ka paraqitur dëshmi të cilat mbulojnë kërkesat e AK në dosjen e tenderit.

Pretendimi juaj i pestë lidhur me diplomat, kontratat e punës referencat,CV si dhe për vendimin për caktimin e menaxherit të projektit, nuk qëndron sepse OE i ka prezantuar;

Pretendimi juaj i gjashtë lidhur me listën e punëtorëve është i pabazuar sepse OE ka paraqitur listën e punëtorëve (18 punëtorë) dhe këto mbulojnë kërkesat e AK në dosjen e tenderit;

Pretendimi juaj i shtatë se nuk ka sigurim të ofertës nuk qëndron sepse e kjo është prezantuar në ofertën e OE.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.



**Kopje:** Operatorit Ekonomik;  
Zyrës së Kryetarit të Komunës;  
Te gjitha palëve të interesuara;  
Arkivit të Komunës